

REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primlajeno:	06.05.2022	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojba Dodatak
01-400/01-22960		



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 06.05.2022

Bazuar në Rregulloren e MF – NR04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ – ve:

**Zyra e Kryetarit të Komunës së Lipjanit dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Lipjanit u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprimtarin e vetë e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit që të aplikojnë për mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në zbatim të objektivit.**

**1. Objektivat e Thirrjes për PVRL :**

- Promovimi i vullnetarizmit
- Integrimi i grupeve të marginalizuara
- Fuqizim i OJQ – ve Rinore
- Edukimi Joformal
- Përgaditja e të rinjve për tregun e punës
- Edukimi shëndetësor dhe mjedisi i sigurt
- Barazia gjinore
- Trashëgimia kulturore , natyrore dhe turizmi
- Infrastruktura Rinore

**Vërejtje : shiko Planin e Veprimit Rinor Lokal 2022-2024 i cili do të jetë shtojcë dhe bazë e kësaj thirrje.**

3. Organizatat jo-qeveritar mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në **avancimin dhe fuqizimin e Rinisë dhe Kulturës në Komunën e Lipjanit**.
4. Numri i OJQ-ve që do të mbështeten nga kjo thirrje publike është një (1) , në përputhje me Planin e Veprimi Rinor Lokal 2022-2024,dhe e cila mund të mbuloj të gjitha fushat prioritare sipas thirrjes.
5. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **36,000.00 euro ( tredhjetë e gjashtë mijë euro)**
5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 30.05.2022.
6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje .

Periodha e zbatimit të projektit është **për 36 muaj**.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ- të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Rinisë dhe Kulturës. OJQ- të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislaconit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale **ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit** dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike. Para nënshkrimit të kontratës, **OJQ- të** duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në **OJQ** dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se **OJQ- ja** ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (<https://kk.rks-gov.net/lipjan/>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

**KOMUNA E LIPJANIT**

**Rruga „Shqipëria”**

**Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,**

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [selman.jashanica@rks-gov.net](mailto:selman.jashanica@rks-gov.net), [anila.reqica.llugiqi@rks-gov.net](mailto:anila.reqica.llugiqi@rks-gov.net).

z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit

